

TRADITA DHE TRASHËGIMIA ISLAME NË KALANË E DODËS

Kalaja e Dodës një unitet etneologjik me vlera të veçanta kombëtare

Pesëmbëdhjetë fshatrat e bashkësive blegtorale të krahinës së Kalasë së Dodës shtrihen në zonën verilindore të Shqipërisë, në veriperëndim të masivit malor të Korabit. Sipërfaqja e krahinës etnologjike të Kalasë së Dodës, brenda kufirit shtetëror të Republikës Shqipërisë është rreth 250 km katrorë.

Krahina e Kalasë së Dodës, me pozicionin e saj gjeostrategjik shumë të rëndësishëm, nga ku sigurohet lidhja më e shkurtër dhe më e lehtë midis ultësirës bregdetare e uginës së Drinit të Zi me Kosovën e Pellgun e Pollogut, me kullosat alpine nga më të mirat në të gjithë zonën e Ballkanit Perëndimor, ku me sukses banorët e kësaj krahine që në lashtësi kanë mbarështuar delen rudë, ka krijuar një shtrat etnokulturor që krahas dukurive të përbashkëta kombëtare e makrokrahinore, ka spikatur edhe disa veçori dalluese jo vetëm në zakone e tradita, por edhe në mënyrën e jetesës. Këto e kanë përcaktuar Kalanë e Dodës si një krahinë etnologjike me vlera të veçanta në tablonë e mozaikut kombëtar të krahinorizmit.

Krahina e Kalasë së Dodës shtrihet në një terren malor me një koeficient të lartë pjerrësie, duke filluar nga 340 m në luginën e Drinit të Zi, deri në lartësitë e Korabit 2754 m mbi nivelin e detit. Brezat klimatikë, ia lëshojnë vendin njëri -tjetrit me një harmoni të paparë, falë ekspozimit të relievit të saj drejt jugut dhe ndriçimit diellor gjatë gjithë orëve të ditës. Befasuese dhe me një bukuri të papërshtueshme ngrihen mbi pllaja plot gjelbërim lartësitë e Korabit, të Sorokolit, të Kallabakut, Kësula e Priftit, Laku i Canit me Kullën e Zyberit, mali i Sukës etj. Nga këto lartësi, marrin burimet e tyre të plotujëshme, lumi i Çajës me degën e tij përroin

e Lumës (Bushticës), lumi i Veleshicës, i Preshticës, Gjinetës, në faqet jugore të të cilëve janë vendosur pothuajse të gjitha qendrat e banuara të krahinës etnologjike të Kalasë së Dodës. Në tokat flishore ujëmbajtëse të këtyre bjeshkëve, në stinët e pranverës dhe të verës gjelbërojnë mijëra lule dhe lloje të ndryshme bari, si: fangu, morava, boronica, sanza, salepi, mjedra, lule basani, manushaqja e bjeshkës, lule delja, lule kumona, e shumë të tjera, mes të cilave, edhe disa bimë endemike që rriten vetëm në bjeshkët e Korabit.

Bjeshkët e Korabit, ku janë vendosur e jetojnë banorët e 15 fshatrave të Kalasë së Dodës, përveç bukurive natyrore, u dhuruan banorëve të këtyre krahinave edhe delen rudë, këtë mbarësi që begatoi jetën e këtyre banorëve jo vetëm nga ana ekonomike, por edhe nga ajo shpirtërore. Shtrirja e këtyre bjeshkëve në një reliev luginash e shpatesh akullnajore të mbuluara me qilimin e barit alpin që lulëzon në gjashtë muajt e verës, si dhe me burimet e panumërta që freskojnë çdo pëllëmbë të saj, krijuan kushte të favorshme që banorët e krahinës të merreshin me mbarështimin e deles rudë.

Jeta e banorëve të bashkësive blegtorale të krahinës së Kalasë së Dodës, e ndërtuar nga ana ekonomike kryesisht me të ardhurat që siguroheshin me mbarështimin e deles rudë, ka udhëtuar midis dy të kundërtave; dhimbjes dhe kënaqësisë. Këto dy përjetime të njeriut, të formuluar që në lashtësi nga Aristoteli në sentencën e njohur “Kënaqësia e dhimbja janë shtysat më të mëdha të jetës shoqërore” kanë qenë “*thimos*” siç e shpreh Platoni ose “sedra” siç i thonë blegtorët e Kalasë së Dodës, për të krijuar atë sistem vlerash që ka përcaktuar identitetin e tyre

Shtegtimi i kopeve të dhenve në Selanik, që ishte jetik për këta banorë dhe tregtimi i prodhimeve blegtorale, solli në kontakt blegtorët e Kalasë së Dodës me banorët e Selanikut dhe të qyteteve tjera në brigjet e Egjeut e deri në Stamboll, ku u njohën me zakone e praktika qytetare të organizimit të jetës në familje, si ato të banimit, të privatësisë në jetën bashkëshortore, të gatimit, të bërjes tregti etj. Këto zakone e praktika, u morën në fillim nga persona të veçantë, që i kishin mundësitë ekonomike, por edhe që kishin pretendime për një jetë më të mirë dhe filluan t’i realizojnë në familjet e tyre, në shtëpitë e tyre, dhe më pas duke parë njëri - tjetrin, në katunde e krahinë, e u bënë pjesë e së drejtës zakonore

të banorëve të fshatrave të Kalasë së Dodës. Kuptohet se ky proces u realizua në dekada, deri sa ato filluan të quhen "Zakonet e Dheut".

Një ndër zakonet me vlera të veçanta dhe pothuajse unike në të gjitha trojet tona kombëtare, që u radhit në vargun e traditave të banorëve të Dheut të Kalasë së Dodës dhe që flet edhe për kulturën e banorëve të këtyre bashkësive është edhe pozita që mori gruaja në jetën e banorëve të kësaj krahine. Vetëm te banorët e fshatrave të Dheut të Kalasë së Dodës, "turpi më i madh për burrin është: ngarkimi i gruas me barrë në shpinë", kur në fshatrat e malësisë ishte diçka normale, madje një detyrim për gruan. Vetë natyra e punës për përpunimin e produkteve blegtorale, të bulmetrave, të përgatitjes së rrobave të shtrojës e të veshjeve që realizoheshin pothuaj krejtësisht me punimin e leshit të deles, si dhe rritja e fëmijëve dhe kujdesi për familjen, e vinin gruan në punë që kryheshin brenda mureve të avllisë apo shtëpisë, jo si robinë, siç shprehet dikush që nuk e njeh jetën, traditën e vlerat e gruas në këtë krahinë, por me statusin e saj si bijë në familjen e babait dhe si bashkëshorte, si nënë e si zonjë shtëpie në familjen e burrit.

Jeta fetare në Kalanë e Dodës

Besimi fetar në fshatrat e krahinës së Kalasë së Dodës është i lidhur ngushtë me besimin e tri shtresave fetare: para të krishterë, të krishterë e islame, të cilat kanë përfutur një sinkronizim të dalluar mirë e që shfaqet në të gjitha sferat e jetës dhe të veprimtarisë së tyre. Ky sinkronizim është arritur duke përthithur e ndërthurur shumë elementë të paganizmit nga besimet e mëvonshme, të cilat janë përshtatur duke marrë edhe emra të ri shenjtësh, por në përmbajtje e ritual ruajnë elementë të besimit pagan (fetishizmit, totemizmit, animizmit, magjish etj.). Këto zbulohen te kultet e natyrës, të bujqësisë dhe të blegtorisë, të familjes, përfshirë edhe kultin e të parëve, të festave e ditëve të shënuara, të figurave mitologjike etj.

Në krahinën e Kalasë së Dodës, elementë të besimit pagan që ruhen e ushtrohen në formë ritesh deri në ditët e sotme, janë të lidhura kryesisht me blegtorinë. Ato i shikojmë të ushtrohen në festa e ditë të shënuara që lidhen edhe me fenomenet e natyrës,

duke formuar një kalendar primitiv të ruajtur deri në ditët e sotme. Ky kalendar, i cili vitin e koncepton të ndarë në dy stinë: verë dhe dimër, dëshmon përsëritjen e fenomeneve natyrore dhe kremtimin e tyre si ditë festash, si: Dita e Verës, Shëngjergji, Shënkolli, Shënmitri, Shëmrajzë etj. Këto emërtime janë të burimit të krishterë, por pas tyre fshihet një festë që kremtohet me rite pagane.

Konceptimi i vitit kalendarik në dy stinë, për blegtorët e Kalasë së Dodës, është i lidhur me shtegtimin e kopeve të deleve, të cilat gjashtë muajt e verës kulloteshin në bjeshkët e Korabit dhe gjashtë muajt e dimrit shtegtonin për në kullotat dimërore në brigjet e Egjeut, dhe pas 1912-ës në brigjet e Adriatikut. Sipas këtij kalendari, Dita e Shëngjergjit është edhe dita e parë e verës dhe dita e vitit të ri. Ajo kremtohet me gjashtë maj. Kjoditë përfaqëson kultin e pjellorisë dhe të prodhimitarisë bujqësore e blegtorale. Gjatë kremtimit të kësaj feste kryhen rite që lidhen pothuajse krejtësisht me paganizmin. Vajzat dhe djemtë e rinj ngrihen herët në mëngjes dhe mbledhin lule, të cilat vendosen në dyert e banesave dhe të ahurit të bagëtive, të mutinit që do të tundnin kosin, si dhe hidhen në ujët e ri, me të cilin do të lahen fëmijët në mëngjes. Djemtë nxjerrin në kullotë bagëtinë duke i nxitur me thupra shelgu të lulëzuara dhe duke vendosur në livadhet që ruhen për t'u kositur, degë të lulëzuara. Qengjave e kecaveu bëhej shenja e familjeve në veshë dhe më pas copat e prera të veshëve hidheshin në një fole milingonash.

Nuk kemi dokumente të mirëfillta arkivore deri në ditët e sotme për prezencën e krishtërit dhe organizimin e tij në krahinën e Kalasë së Dodës,. Mbi këtë periudhë hedhin dritë kryesisht objektet fetare (kishat), si dhe toponimet e vendeve me emra të krishterë, që gjenden pothuaj në çdo fshat, dhe datojnë duke filluar që nga koha e mbretërimit të perandorit ilir, Justinianit (527-565). Zbulimi në Kodrën e Pecës, në vendin ku bashkohet Drini i Bardhë me Drinin e Zi, në Kukës, nga L. Përzhita, në vitet '80 të shekullit të kaluar, i një kishë paleokristiane, që i përket shek. V-VI, tregon se krishtërimi ishte bërë pjesë e jetës edhe në luginën e Drinit të Zi, pjesë e së cilës ishin edhe fshatrat e Kalasë së Dodës.⁽¹⁾

⁽¹⁾ "Kështjella e Pecës në periudhën e aktivitetit të vonë dhe në mesjetë", Iliria, 1, 1990, f. 201.

Në krahinën e Kalasë së Dodës, vetëm pas viteve 1850-1860, udhëtarë e konsuj të huaj, si: Ami Boue, Hahn, Jastrebov etj, realizuan udhëtime në itinerarin e Udhës së Madhe, duke përshkuar luginën e Drinit, nga Ohri e deri në Prizren, dhe me shkrimet e tyre na kanë lënë njoftime me vlera për jetën ekonomike, shoqërore e fetare, edhe të banorëve të Kalasë së Dodës.

Në vitin 1863, konsulli austriak, J. G. von Hahn, me qëllim që të vizitonte Kalanë e Dodës, kryen një udhëtim në luginën e Drinit të Zi dhe e pasqyron në librin **Udhëtim në Luginën e Drinit e Vardarit**. Kështu, në kapitullin “Radomira”, ai shkruan: “Radomira është shpërndarë në pesë lagje mbi shpatin jugor në trajtë konkave, të kurrizit të fuqishëm malor të Korabit, mbi kreshtën e të cilit ndodhet e ashtuquajtura, Kala e Dodës. Banesat pranë të cilave patëm rastin të kalojmë, dëshmonin pothuajse të gjitha, që banorët e tyre gëzonin një mirëqenje, e cila i kalonte në mënyrë të ndjeshme parashikimin që mund të bëhej..... në viset për qark njihen gjithashtu edhe shumë vende të tjera, ku dikur kanë ekzistuar kisha të krishtera. Ne patëm rastin të kalojmë vetë pranë vendeve ku gjenden gjurmët e qyteteve të hershme”.⁽²⁾

Ndër këto kisha e vende të krishtera, interes paraqet kisha, a manastiri i Tallamasit, që thuhet se ka qenë kryeqendër e kishave të zonës, e cila ndodhet midis fshatit Shullan dhe Radomirës. Për këtë objekt fetar shkruan edhe studiuesi rus Jastrebov, në gjysmën e dytë të shekullit XIX, i cili thotë: “Midis Veleshicës dhe Çernjevës, është një vend me disa rrënoja që mban emrin Tollumbas. Në majë të kodrës duket qartë manastiri. Ka aty edhe një varrezë. Në anën jugore ende duket dera e manastirit përmbi lum”.⁽³⁾ “Stara Serbia i Abania, 1904, f. 214.

Rrënoja kishash dhe toponime kemi në fshatin Ceren, toponimin me emrin Livadhi i Kishës; në Vasije, kisha dhe toponimi Kroj i Domallit; në Bushtricë, Kisha e Gjice, Kisha e Truçit, Kisha e Tushe; në Kalisë, Kisha e Shehit dhe Kisha e Limës; në Fshat, Kisha dhe lagjja Shënmëria, ku ka pasur edhe një kishë me të njëjtin emër; në Çajë, toponimet Guri i Kishës dhe Ksula e Priftit etj.

Për mungesë dokumentacioni është e pamundur të pasqyrohet ecuria e procesit të krishtërimit edhe në fshatrat e Kalasë së Dodës,

⁽²⁾ Nëpër viset e Drinit, Tiranë, 2001, f. 221.

⁽³⁾ Stara Serbia i Abania, 1904, f. 214.

dhe aq më pak të vëmë një vijë ndarjeje midis kishave të ritit latin me ato të ritit grek, veçanërisht kjo për kohën nga shekulli VII deri në shekullin XI, kohë e cila përkon me ardhjen e sllavëve në Ballkan. Sipas Zef Mirditës, kufiri ndarës i Kishës Katolike Romane me Kishën Ortodokse Bizantine në vitin 1054 ishte rrjedha e Drinit të Zi.⁽⁴⁾ Por, duhet thënë se edhe pas vitit 1219, kur vëllai i mbretit Stefan Nemanja, Sava, mori autoqefalinë e kishës serbe duke zgjedhur Pejën si seli të saj, kisha serbe asnjëherë nuk e ka kaluar vargmalin e Sharrit, kështu që fshatrat e krahinës së Kalasë së Dodës, duke qenë në vijë ndarjeje midis Kishës Romane me Kishën Ortodokse Bizantine, nuk kanë përjetuar asnjëherë varësi nga kisha serbe.

Islami në krahinën e Kalasë së Dodës

Për zanafillën e procesit të islamizimit në viset e Kalasë së Dodës, pothuajse mungojnë dokumente të mirëfillta arkivore. Duke u bazuar në punimet shkencore të Selami Pulahës, në përkthimin e studimin e defterëve kadastralë osmanë të shek. XVI (1529-1539, 1571-1591) ⁽⁵⁾, si dhe në shkrimet e udhëtarëve dhe të diplomatëve të huaj që e kanë vizituar këtë krahinë, si: E. Durham, Hahn, Jastrebov etj., është hedhur dritëmbi proceset e islamizimit dhe shkaqet që e mundësuan atë për t'u bërë pjesë e jetës edhe për banorët e fshatrave në krahinën e Kalasë së Dodës.

Islamizimi, si proces, nuk qe i menjëhershëm edhe në fshatrat e Kalasë së Dodës. Ai ka hyrë shkallë-shkallë e fshat pas fshati edhe në këtë vis, por duke pasur gjithmonë veçori, që erdhën si rezultat i pozitës gjeostrategjike të fshatrave të këtij visi, të drejtimit ekonomik që kishin banorët e këtyre fshatrave, kryesisht mbarështimin e deles rudë, si dhe të kaluarës fetare dhe zhvillimeve historike-shoqërore, veçanërisht të gjysmës së dytë të shekullit XV dhe fillimit të shekullit XVI.

Studiuesja angleze, Edit Durham, përmend disa faktorë që ndikuan në islamizimin e trojeve arbërore. Ajo shkruan: "Islamizimi ishte më shumë rrjedhojë e një propagande të

⁽⁴⁾ **Historia e Kishës**, f. 18-20.

⁽⁵⁾ "*Krahina e sanxhakut të Dukagjinit gjatë shek. XVI*", në "*Studime Historike*", Nr. 3-4, 1973.

pandërprerë, e bindjes dhe e shpërblimeve, por jo e persekutimit... Feja e Muhametit i ka dhënë atij toka pjellore, poste sunduese në qeveri dhe nuk e ka detyruar të bëjë shërbim ushtarak; e ka paguar mirë kur i ka dashur qejfi të luftojë dhe kurrë nuk e ka shqetësuar se si ta mësojë islamin, por e ka lënë të lirë të ruajë zakonet e vjetra”⁽⁶⁾. Janë pikërisht këto faktorë, që përcakton kjo njohëse e shkëlqyer e jetës dhe realitetit historik të kohës, që sollën islamizimin edhe të bashkësive blegtorale të krahinës së Kalasë së Dodës, duke krijuar një mjedis fetar popullor dhe larg intolerancës e fanatizmit.

Zhvillime të dukshme të përhapjes së islamizimit në krahinën e Kalasë së Dodës filluan që në periudhën e sulltan Sulejmanit (1527-1565), i cili me reformat e guximshme ushtarake e administrative krijoi një mjedis të sigurtë pune dhe veprimtarie shoqërore në të gjitha skajet e perandorisë. Në Kala të Dodës u vendos një garnizon i përhershëm ushtarak në roje të rrugëkalimeve dhe të institucioneve të Kazasë (Kalaja e Dodës ishte kryeqendra e Kazasë së Lumës). Në këtë kohë, për blegtorët e Kalasë së Dodës, rruga e shtegtimit të blegtorisë për në kullotat dimërore në brigjet e Egjeut, njohu sigurinë më të madhe dhe njëkohësisht solli edhe kontaktet e para me fenë islame, parimet e së cilës përshtateshin në mënyrë të përsosur me veprimtarinë, punën dhe me mënyrën e jetesës së këtyre blegtorëve.

Ndikim të rëndësishëm në përqafimin e fesë islame nga banorët e fshatrave të bashkësive blegtorale të Kalasë së Dodës, pati edhe fermani sulltanor i vitit 1585, lëshuar nga sulltan Murati III (1574-1595), me nxitjen e Gazi Sinan Pashë Topojanit. Këtë dokument na e bën të njohur konsulli rus Jastrebov, të përkthyer nga osmanishtja në rusisht, në librin **Stara Srbia i Albania**, botuar në vitin 1904 dhe historiani Hasan Kaleshi në studimin “*Veliki vezir Sinan Pasa*” të përkthyer nga osmanishtja në serbo-kroatisht, botuar në “Gjurmime Albanologjike”, nr. 2, 1965.

Sipas këtyre dy autorëve, thuhet se deri në mesin e shek. XX, ruhej në familjen e Iljas Agës (Topojan) një ferman sulltanor i vitit 1585, lëshuar nga Sulltan Murati III (1574-1595) me kërkesën e Sinan Pashës, në atë kohë sundimtar i ejaletit të Damaskut. Fermani sulltanor ishte shkruar më germa të arta dhe kishte

⁽⁶⁾ E. Durham, **Brenga e Ballkanit**, Tiranë 1998, f. 201.

përmasat: 8 pëllëmbë gjatësi, 2 pëllëmbë gjerësi, i shkruar në 13 radhë. Fermani kishte këtë përmbajtje: "Ish -Veziri im i Madh, e tani i ngarkuar nga ana ime Vali i elajetit të Damaskut, Sinan Pasha, me qëllim që të bëjë një vepër të mirë, katundet e veta Çajla (Çaja) që çdo vit sjell 6000 akçe, Flura (Turaj) që sjell 4000 akçe, Topojani që sjell 5000 akçe, Kalaisi (Kalaja ose Kalisi) me 8000 akçe, Beleshqa (mundet Beshe ose Bloshtan) më 3000 akçe, i ka falë për jetë të jetës, rajës së këtyre katundeve të gjitha bjeshkët, malet, kullotat, arat, kopshtet. Për të vërtetuar këtë, lëshoj këtë ferman dhe urdhëroj që askush të mos guxojë të marrë nga katundet e lartpërmendura as të ardhura toke, as të ardhura për dele, domethënë kurrfarë tatimi a detyrimi tjetër nga toka, e cila tani kalon në posedim të tyre". Bashkëfshatarët e Sinan Pashë Topojanit,- shkruan Jastrebov,- mbetën shumë të kënaqur nga ky akt dhurimi, prandaj nuk refuzuan të myslimanizoheshin. Myslimanizimi u hapte shtigje këtyre blegtorëve të shtonin blegtorinë pa paguar taksën e xhizjes, nga e cila përjashtoheshin të myslimanizuarit, të shkollonin fëmijët, dhe për t'u ngjitur deri edhe në shkallët më të larta të qeverisjes perandorake, ashtu siç ishin ngjitur bashkëvendasit e tyre, Sinan Pashë Topojani, Ferat Pashë Topojani, Sofi Sinan Pashë Vila etj.

Më 1537-n, u shpall një ferman sulltanor, i cili urdhëronte ndërtimin e xhamive në çdo katund dhe përfaqësuesit e pushtetit detyroheshin që ditën e premte, të merrnin pjesë në lutje, së bashku me masën e besimtarëve. Ndërtimi i xhamive si qendra shkollore dhe si qendra të bashkimit të njerëzve (besimtarëve) me vullnet të mirë, ku kryhej namaz i përbashkët, ndikoi shumë në njohjen e parimeve të fesë islame dhe ushtrimin e riteve të saj. Kështu, kohë pas kohe, u ngritën xhami e teqe dhe më pas edhe mejtepe pranë xhamive e teqeve, pothuaj në të gjitha fshatrat. Xhamitë e para u ngritën në Vilë e Ploshtan, pastaj në Fshat, Ceren, Radomirë, Çajë, Shkinak, Letën, Buzmadhe, si dhe në Gjegje, Palush, Bushtricë, Kalis e Lusën.

Në këtë kohë, në shoqërinë dhe në mbrojtjen e blegtorëve, filluan të vijnë në fshatrat e Kalasë së Dodës edhe dervishët e teqeve, të cilët kanë pasur një rol të rëndësishëm në përhapjen e islamit në këto fshatra. Baballarët, siç i quante populli, ishin njerëz të thjeshtë dhe shumë praktikë në propagandën e tyre, për të bërë

të njohura parimet dhe ushtrimin e riteve të fesë islame. Teqet, të cilat bënë emër pothuaj në të gjitha fshatrat e brezit bjeshkor të Korabit, në Cerenë, në Vasije, në Gjegje, në Fshat, në Buzmadhe, në Çajë e në Kalisë, krijuan një mjedis fetar popullor, larg intolerancës e fanatizmit doktrinor, duke ndikuar në përhapjen e islamit edhe në fshatrat katolike kufitare të matanë Drinit, si në Ujmisht, Reç, Dadhë, Arrën, Lurë etj.

Teqet që u ngritën në fshatrat e krahinës së Kalasë së Dodës i përkisnin tarikatit Halveti, vetëm teqja e Shehut të Çajës ishte e tarikatit Kadri. Teqet e të gjitha fshatrave të kësaj krahine ishin të vendosura me strehime, ku varroseshin edhe baballarët e mëdhenj të teqes. Emri i tarikatit të sekti Halveti, lidhet me themeluesin e tij, Omer el Halveti nga Tarabizi i Iranit, shek XIV. Praktika fetare e sekti "Halveti", zhvillohet në tërheqjen e besimtarëve në një dhomë të veçantë për të kryer ritin e "Zikrit", i cili lidhet me përmendjen e Zotit në zë të lartë nën emërtime të ndryshme të gjetura posaçërisht.⁽⁷⁾

Sipas gojëdhënës, e para teqe e ngritur në Kalanë e Dodës, të parët e së cilës kanë ardhur nga Horosani i Iranit, rreth viteve 1400, ka qenë Teqja e Murat Dedës në Ceren. Kjo teqe, e tarikatit Halveti, që ka nxjerrë personalitete me vlera të shumta njerëzore e fetare, ka bërë shumë për përhapjen e konsolidimin e fesë islame edhe në fshatrat e malësisë, si: Vilë, Ujmisht, Arrën, Surroj e Lurë, por edhe ka ndihmuar në zgjidhjen e mjaft halleve e problemeve në këto fshatra, si pajtim gjaqesh, shuarje ngatërresash etj. Teqja e Murat Dedës në Ceren ka qenë edhe modeli i ndërtimit të punës e veprimtarisë edhe i teqeve të tjera të ritit "Halveti", jo vetëm në krahinë, por pothuaj në të gjithë pellgun e Drinit, Lumë e Dibër.

Nga të dhënat kadastrale osmane, të botuara nga Selami Pulaha,⁽⁸⁾ del se islamizimi në fshatrat e nahijes së Dibrës⁽⁹⁾, kishte nisur që me fillimet e shek. XVI, madje edhe më përpara. Më 1571-n, nga 526 shtëpi të fshatrave të nahijes Dibër, 437 ishin me banorë

⁽⁷⁾ Historia e popullit shqiptar, I, Tiranë, 2002, f. 596

⁽⁸⁾ Shih: "Krahina e sanxhakut të Dukagjinit, gjatë shek. XVI", në "Studime Historike", V. 3-4, 1973

⁽⁹⁾ Kështu emërtohej krahina e Kalasë së Dodës, territori i së cilës shtrihej nga gurra e Kolesjanit deri në rrjedhën e lumit Veleshicë dhe ishte pjesë e sanxhakut të Dukagjinit.

të krishterë dhe 89 me banorë myslimanë. Kurse në regjistrimin e vitit 1591, kemi 376 familje me banorë të krishterë dhe 158 familje me banorë myslimanë, pra nga 20% e banorëve të islamizuar më 1571-n, më 1591-n numri i banorëve të islamizuar rritet rreth 40%.

Procesi i islamizimit të banorëve të fshatrave të Kalasë së Dodës, do të përfundojë plotësisht nga mesi i shekullit XVII.

Krahas procesit të myslimanizimit, në fshatrat e Kalasë së Dodës, ka ecur edhe përgatitja e klerit mysliman. Në fillim, imamët e xhamive kanë ardhur nga vise të myslimanizuara më herët, ku qenë ngritur medrese për të përgatitur hoxhallarë e misionarë të islamit, si në Prizren, Shkup, Tetovë, Selanik, Stamboll. Më vonë, bij blegtorësh shtegtarë e familjesh të pasura nga krahina, që nuk ishin të pakta, u shkolluan në këto medrese, duke formuar klerin mysliman vendas, deri edhe me grada e tituj shkencorë, si imamllarë, hafuzllarë e deri shehulislam, siç ishte hafuz Hysen Sadik Gjoniku nga Radomira, i cili në fillimet e shek. XX. u shpall si zëvendësshehulislam.

Në Salnamen e Vilajetit të Prizrenit të vitit 1873⁽¹⁰⁾ shënohet se, "Në nahijen e Kalasë ka 7 mejtepe me 350 djem e 100 vajza". Thuhet gjithashtu se "në këtë nahije ka kullota të begatshme, sa që kullosnin në to me qindra e me mijëra gjë e gjallë".

Hapja e shkollave fetare (mejtepeve), në Ploshtan, Radomirë, Ceren, Vasiqe, Gjegie, Fshat, Kalis, Vilë e Lusën, dhe dhënia e mësimi nga intelektualë të njohur, edhe me tituj e grada shkencore, si hafuz Shtini e hafuz Darsi në Fshat, hafuz Nexhipi e hafuz Tasim Ahmati në Radomirë, hafuz Potja në Palush e hafuz Shabani nga Prishtina, si dhe imamllarët Molla Vehbia, hoxhë Cereni, molla Sadiku, molla Tefiku e molla Gafurri, në Radomirë Ceren e Ploshtan, hoxhë Vasia, haxhi Rexhepi e sheh Veseli në Vaije, molla Sadik Potja, molla Halil Palushi, hoxhë Lita e molla Osman Hasa në Palush, Bushtricë e Gjegie etj., të cilët me interpretimet dhe predikimet e tyre dhe në bashkëveprim me shehlerët e teqeve, krijuan një mjedis fetar, ku parimet e islamit gjetën një shtrat përbashkësish kulturore dhe pika të shumta kontakti, me kulturën e jetesës dhe zakonet e traditat e këtij visi.

⁽¹⁰⁾ Hasan Kaleshi, H. Jurgen, "Vilajeti i Prizrenit", Përparimi 2, Prishtinë 1967, f. 298.

Çfarë ndryshimesh u shënuan në jetën fetare, kulturore dhe zakonore të banorëve të Kalasë së Dodës, me islamizimin e tyre? Alija Izetbegović, në librin **Islami ndërmjet Lindjes e Perëndimit**, shkruan: “Islami, si formë e vetëdijes shoqërore, bazohet në parimin e unitetit të shpirtit dhe të materies, forma më e lartë e të cilit është jeta njerëzore. Ky dualizëm nuk është vetëm shprehje e botëkuptimit islamik mbi botën, por edhe mënyra për ta rregulluar atë, e cila shprehet në pesë rregullat themelore të islamit”.⁽¹¹⁾

Njohja me këto rregulla të islamit dhe detyrimi religjioz për t'i zbatuar ato, gjeti aq përshtatshmëri dhe pika takimi me proceset e zhvillimit të jetës, të zakoneve e traditave të banorëve të Kalasë së Dodës, sa duket sikur vetë jeta e këtyre banorëve e gjeti rrugën e islamit.

Një nga rregullat themelore të islamit që gjeti një shtrat kulturor dhe përbashkësi deri në intimitet me jetën e banorëve të Kalasë së Dodës ishte namazi, (lutja islame). Namazi, nëpërmjet dy aspiratave: “As lutje pa pastërti dhe as përpjekje shpirtërore pa përpjekje të njëkohshme fizike e shpirtërore”, ndërtoi një dimension të ri në organizimin e jetës për banorët e myslimanizuar të këtyre fshatrave. Falja e pesë namazeve gjatë 24 orëve, duke kryer dy elementët racionalë të namazit, pastrimin (abdestin) dhe lëvizjet në procesin e faljes, jo vetëm gjallëruan jetën e banorëve, veçanërisht atë të të moshuarve dhe grave, por pas ndërtimit të xhamive e teqeve dhe kryerjes së namazit të përbashkët (në xhami me Xhematë), namazi fitoi edhe një dimension të ri shoqëror. Namazi i përbashkët në xhami i bashkonte besimtarët, jo vetëm për lutje të përbashkëta, por edhe për takime të drejtpërdrejta midis tyre, ku këmbenin mendime, merrnin informacion, dëgjonin imamët që bënë zbërthimet e Ajetëve të Kuranit dhe jepnin edhe porosi për ndërtimin e jetës me punë të ndershme dhe larg haramit e punëve të këqija. Kështu, namazi i përbashkët, ku merrnin pjesë edhe gratë, për bashkësitë fshatare të Kalasë së Dodës, mori atributet e një shkolle të bashkimit të përditshëm të besimtarëve vullnetmirë

Namazi islam, duke mos qenë vetëm lutje por edhe disiplinë, duke e shpallur pastërtinë si aspekt besimi: “Zoti i do më shumë

⁽¹¹⁾ Alija Izetbegović, “Islami midis Lindjes e Perëndimit”, Sarajevë 1990, kapitulli “Islami dhe jeta”.

ata që janë me shpirt e trup të pastër”, solli dukuri të reja në kulturën e jetesës, veçanërisht të gruas, në krahinën e Kalasë së Dodës. Ndërtimi i hamameve dhe pastrimi i deryruar, pesë herë në ditë, para faljes së namazit, jo vetëm që krijoi një kulturë higjienike të admirueshme trupore dhe pastërti në mjedisin ku njeriu jetonte, por higjiena, duke mos qenë vetëm dituri por edhe virtyt, solli edhe organizimin e jetës në një mënyrë të re, duke u bërë shprehje kryerje e punëve në kohë të caktuar dhe bëri që përtacia e neglizhenca të mos kishin vend më në jetën e tyre të përditshme.

Rregullat islame, duke mos synuar të kultivojnë te njeriu cilësi që nuk bazohen në natyrën e tij: “Që bota materiale nuk është mbretëri e djallit dhe trupi nuk është vatër e mëkatit”, ishin për një jetë të natyrshme. “Besimtarë, mos ia ndaloni vetes gjërat e bukura dhe të pastra që jua ka lejuar Zoti, por mos e teproni”, - thuhet në një ajet kuranor⁽¹²⁾. Pranimi i kënaqësisë së dashurisë, duke e quajtur martesën një kontratë me të cilën lidhet çifti për të qenë ortak në jetë dhe ndalimet e lejimet e përcaktuara në ajetet kuranore, formuan për institucionin e martesës dhe jetën familjare, në këto bashkësi, rregulla që e ngritën në një stad më të qytetëruar organizimin e jetës në familje. Martesa, duke u kurorëzuar para një institucioni që ishte edhe fetar edhe shtetëror nga kadiu, në prezencën e dëshmitarëve, legjitimohej duke u quajtur një kontratë, e cila edhe mund të zgjidhej nëpërmjet shkurorëzimit, megjithëse si gjëja më e shëmtuar e së lejueshmes, i jepte status tjetër femrës në jetën shoqërore.

Nga rregullat islame, zekati, “lëmosha e detyruar”, gjeti një përshtatshmëri ideale me zakonet e traditat e jetës së banorëve të bashkësive blegtorale të Kalasë së Dodës. Shtegtimi i blegtorisë për dimërim në zonat e ngrohta bregdetare dhe verës në bjeshkët e Korabit, përbënte një nga aktivitetet jetike më të rëndësishme të banorëve të bashkësive blegtorale të Kalasë së Dodës, nëpërmjet të cilit sigurohej ekzistenca e dhenvë, burimi kryesor i jetesës së tyre. Rrugët dhe veprimet e përbashkëta të blegtorëve e çobanëve dhe përballimi i vështirësive duke ndihmuar njëri- tjetrin, krijuan lidhje tepër të sinqerta dhe të qëndrueshme, të cilat reflektoheshin edhe në familjet e tyre, duke i kthyer këto vlera në zakone tepër

⁽¹²⁾ Kuran, 5:45.

njerëzore e fisnike. Tek këto zakone e tradita, tepër të veçanta të banorëve të këtyre bashkësive, veçanërisht në atë të ndihmës ndaj njëri -tjetrit dhe njerëzve në nevojë, që nuk jepej në formë lëmoshe, por si ndihmë për të kaluar fatkeqësinë apo gjendjen e vështirë ekonomike, gjeti terren edhe zekati. Me myslimanizimin e banorëve të këtyre bashkësive, zekati u bë i detyrueshëm, si i pari tatim që i pasuri duhej të paguante ndaj të varfërve. Ashtu si nga lutja u bë i detyrueshëm namazi, nga lëmosha u bë i detyruar zekati.

Zekati, duke qenë përgjigje ndaj një dukurie jo vetëm sociale por edhe shpirtërore, u kthye në virtyt për jetën e banorëve të këtyre bashkësive, sa dorëdhëninë e vendosin si të parin kusht për të fituar xhenetin e jetës së amshuar. Ja si shprehet kjo në vargjet e një “ilahie”, që këndohej edhe nga gratë, në teqen e Sheh Misk Allamanit në Vasie:

“Kur t’vi dita e ahiretit, me na falë t’lumin xhenet, / Do t’i lutna t’madhit Zot, t’ue ra në ishadet. / Ky xheneti rri e pret, lum kush ep me dorë të vetë. / Ma i pari, dorë-dhani. / Për së dyti ashtë shehidi (luftëtarë në udhën e zotit). /Për së treti ashtë Llahustra (gruja që vdes në lindje)”.

Këto tri vargje të kësaj ilahie, duke i vëzhguar në thellësi, na zbulojnë se ky trinom ka qenë baza mbi të cilën është ndërtuar jeta ekonomike, shoqërore dhe fetare e banorëve të kësaj krahine në të gjitha drejtimet e saj.

Ndikim të rëndësishëm në lartësimin e vlerave morale e shpirtërore të banorëve të krahinës së Kalasë së Dodës kanë pasur lejimet dhe ndalimet e urdhëruara në ajetet kuranore, ku u kushtohet rëndësi e veçantë mirëqenies së njeriut, mënyrës së drejtë të fitimit dhe posedimit të pasurisë e shpenzimet e saj, si dhe ndalesa e fajdes, e ushqyerjes me produkte të konsideruara haram, trajtimit të familjes, veprimeve imorale etj.

Që kur ka filluar jeta mbi tokë, njerëzimi vendosi rregulla për të jetuar. Ato janë transmetuar nga brezi në brez në formë ndalimesh e lejimesh. Shumë prej këtyre rregullave dhe ligjeve janë shkruar në libra shumë të hershëm të kulturës sumerjane dhe janë bërë të detyrueshme për t’u zbatuar, kryesisht në ata popuj që hynë në një organizim shtetëror më të hershëm. Rregullat kuranore, në saj të zbatimit të vullnetshëm të tyre, se kjo botë e kjo jetë nuk

janë të vetmet, detyronin zbatimin vullnetmirë të tyre duke lidhur moralin me religjionin.

Të gjitha lejimet dhe ndalesat e detyruara në ajetet kuranore bazohen në dysinë e natyrës së njeriut, nisur nga fakti se ai s'mund të ekzistojë vetëm si qenie biologjike pa anën shpirtërore të tij. Lejimet e ndalimet në rregullat kuranore gjetën shtrat e përbashkësi në të gjitha fushat e jetës dhe të organizimit shoqëror të banorët e Kalasë së Dodës. Shpjegimi i thjeshtë, i kuptueshëm dhe shkencor i vlerave që do të sillnin në jetën e njerëzve lejimet dhe ndalimet që urdhëronin rregullat kuranore, nga imamë e shehlerë të përgatitur, që i kryenin me korrektesë në jetën personale dhe në familjet e tyre këto rregulla, krijuan një opinion të fortë dhe detyrues në zbatimin e tyre. Kjo bëri që niveli i jetesës të banorët e krahinës së Kalasë së Dodës të arrinte një hop cilësor që ishte i dukshëm në krahasim me krahinat përreth. Po kështu, zbatimi i këtyre rregullave solli ndryshime edhe në formimin shpirtëror e moral të një niveli me njerëzor në zgjidhjen e problemeve të jetës në bashkësi.

Jeta fetare në fshatrat e Kalasë së Dodës ka kaluar dy prova tepër të vështira qëndrese e devotshmërie, që vetëm një popull me moral të lartë fetar e kurajo mbijetese jo të zakonshme, mund t'i përballonte. Goditja e parë ishte ajo e viteve 1913-1921, kur ushtritë serbe jo vetëm shkuan në bajonetë dhjetëra banorë të kësaj krahine, duke mos kursyer as gratë e fëmijët, grabitën të gjithë pasurinë, me mijëra kokë bagëti, veshje e të holla, por dogjën dhe shkretuan edhe të gjitha institucionet fetare, xhami e teqe. Por, ata nuk mundën ta zhbëjnë ndjenjën fetare dhe shpirtin e solidaritetit dhe të ndihmës ndaj njëri-tjetrit., Brenda pak vitesh ata rimëkëmbën ekonominë, duke krijuar tufët e deleve, megjithëse jo më si para pushtimit serb dhe ringritën institucionet fetare në të gjitha fshatrat.

Jeta fetare dhe zhvillimi ekonomik patën një rritje të dukshme veçanërisht në vitet 1941-1945, kur Kosova dhe Pollogu u bashkuan me Shqipërinë. Lëvizja e lirë e banorëve të krahinës së Kalasë së Dodës për në tregjet e Prizrenit, Tetovës e Gostivarit, jo vetëm që gjallëruan jetën ekonomike të këtyre banorëve, por solli edhe kënaqësi shpirtërore, sepse u larguan nga trojet shqiptare pushtuesit serbë që e kishin shkatërruar jetën ekonomike e fetare në këto krahina...

Goditja e dytë mbi ekonominë dhe vlerat shpirtërore-morale dhe fenë, për banorët e fshatrave të Kalasë së Dodës ndodhi në hapësirën e viteve 1960. Kolektivizimi i bujqësisë dhe lufta kundër fesë sollën pasoja të pariparueshme në jetën tyre. Vetëm besimi dhe lidhja vëllazërore e qëndrueshme, dhunti e veçantë e banorëve të kësaj krahine, krijoi mundësinë e ruajtjes së besimit islam dhe kryerjen e disa shërbesave fetare, edhe pse në kushte ilegaliteti.

Në përfundim, mund të themi se islamizimi solli në Kalanë e Dodës ndryshime të dukshme në organizimin shoqëror dhe veçanërisht në kulturën e jetesës së këtyre banorëve, si dhe ndikoi në formimin e personalitetit të tyre me vlera më të lartësuar në fe, moral e qytetari. Këto vlera nuk u shuan edhe pas tronditjeve të mëdha të luftës kundër zakoneve prapanike e paragjytimeve fetare të vitit 1967, kur u shembën teqe e xhamia. Kjo luftë nuk arriti kurrë që këta njerëz të largonin nga jeta e tyre besimin, vlerat morale dhe ushtrimin e riteve dhe të parimeve të fesë islame, pasi ato ishin bërë pjesë e pandarë e ekzistencës së tyre.

Burimet

- Përzhita, Luan. *Kështjella e Pecës në periudhën e antikitetit të vonë dhe në mesjetë*, "Iliria", 1, 1960.
- Johann G. von Hahn. **Nëpër viset e Drinit**, kapitulli "Radomira". Tiranë, 2001.
- Mazreku, P. "Relacion i vitit 1638", në, **Relacione mbi gjendjen në Shqipërinë Veriore dhe të Mesme, II** (1635-1650) Tiranë, 1965.
- Hoxha Shefqet. **Kërkime për besimet fetare në Lumë**. Tiranë, 2005.
- Selami Pulaha. "Krahina e sanxhakut të Dukagjinit gjatë shek. XVI, në "Studime Historike", 3, 1973.
- E. Durham. **Brenga e Ballkanit** (Shqipëria e Epërme). Tiranë, 1998.
- Hasan Kaleshi. "Veliki Vezir Sinan Pasa" në "Gjurmime Albanologjike", nr. 2, 1965.
- **Historia e popullit shqiptar**, Tiranë, 2002.